



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës – Vlada Kosova – Government of Kosovo



MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS
DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE AND TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKE I TEHNOLOGIJU

QENDRA E STUDENTËVE
E UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS
PRISHTINË

STUDENTS' CENTER OF
UNIVERSITY OF PRISHTINA
PRISHTINA

STUDENTSKI CENTAR
UNIVERSITETA PRISHTINE
PRISHTINA

Bruga "Agim Ramadani" p.n., 10 000 Prishtinë, Kosovë
Tel.: +381 (0) 38/223-951, +381 (0) 38/225-976
Ëeb:qs.rks-gov.net

Qendra e Studentëve në Prishtinë shpallë:

12.09.2022

KONKURS

Për pranimin e studentëve në konvikte dhe ushqim në mensën e studentëve për vitin Akademik 2022/2023.

Aplikimi bëhet përmes sistemit **ONLINE**. Linku për aplikim është i publikuar në web faqen zyrtare të QS-së **qs.rks-gov.net** dhe në profilin zyrtar në facebook **Qendra e Studenteve-Prishtine**. Udhëzuesi për aplikim gjendet në linkun e shfaqur.

Këtë vit Akademik, studentët e rregullt të UP-së, kanë mundësi të aplikojnë veçmas për të fituar të drejtën për t'u ushqyer në mensën e studentëve. Kriteret për të aplikuar janë të njëjta sikurse për aplikim për konvikt. Numri i studentëve që do të përfitojnë për ushqim në mensë, është 1500 student.

Në konviktet dhe mensën e QS-së pranohen studentët e rregullt të studimeve themelore, komuna e të cilëve është 25 km e më larg nga Prishtina.

Kriteret për pranim dhe pikët e mundshme:

- Studentët nga Fakulteti i Mjekësisë, Fakulteti Teknik dhe Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore me notë mesatare 9.00 dhe me largësi 25 km e më shumë nga Prishtina, pranohen në konvikte pavarësisht totalit të pikëve që fitojnë.
- Studentët nga fakultetet e tjera me notë mesatare 9.5 dhe me largësi 25 km e më shumë nga Prishtina pranohen në konvikte pavarësisht numrit të pikëve të fituara.
- Studentët për notë mesatare fitojnë (varësisht nga nota mesatare).5-15 pikë
 - Largësia nga Komuna e Prishtinës.....2-10 pikë
 - Studentët jashtë territorit të Republikës për largësi marrin.....15 pikë

Studentët me status të vaçant për pikë shtesë sipas kategorive:

- student (fëmijë) i dëshmorit10 pikë
- student (fëmijë) i prindit invalid të luftës5 pikë
- student, prindi i të cilit është veteran i luftës3 pikë
- student i të pagjeturit5 pikë
- student invalid civil i luftës5 pikë
- student i prindit martir nga lufta4 pikë
- student me aftësi të kufizuara6 pikë
- student i të burgosurit, politik4 pikë
- student me asistencë sociale4 pikë
- dy e më shumë studentë nga një familje aplikant në QS3 pikë

Të gjithë studentët e këtyre kategorive të cilët përfitojnë pikë shtesë duhet që përmes sistemit ONLINE të ngarkojnë dokumentacionin e kërkuar (vertetimin)nga :

- Shoqata e të Burgosurve Politik, zyra qendrore Prishtinë**
- Shoqata e personave me Aftësi të Kufizuara – Hendikos, zyra qendrore Prishtinë.**
- Shoqata e familjeve të dëshmorëve – Selia qendrore në Prishtinë**
- Studenti i prindit martir nga lufta, student i të pagjeturit, student invalid civil i luftës vendimi i MPMS dhe çertifikata e bashkësisë familjare.**
- Studentët , prindërit e të cilëve janë veteran të Luftës , e të cilët marrin pagë nga Buxheti i Republikës së Kosovës, e ngarkojnë çertifikatën e veteranit të prindit , të lëshuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ndërsa studentët prindërit e të cilëve nuk marrin pagë nga Buxheti i Republikës së Kosovës nuk kanë nevojë t'a bëjnë ngarkimin e çertifikatës së prindit veteran, sepse pikët i'u llogariten nga vet sistemi, nga të dhënat e MPMS.**

Sqarim: Njoftojmë studentët se pikët e fituara nga nota mesatare, nga largësia, student i prindit invalid të luftës, studentëve me asistencë sociale pikët i'u llogariten përmes sistemit online. Andaj nuk është e nevojshme që këto dokumente të ngarkohen gjatë aplikimit.

- Te kategoria dy e më shumë studentë nga një familje, aplikuesi për vendosje në QS me rastin e aplikimit studenti i dytë apo i tretë nga e njejta familje, duhet të shkruaj nr. e letërnjoftimit të aplikantit të parë , në opsionin e hapur për këtë kategori.**
- Konkursi mbetet i hapur deri me datën **18.09.2022** nga dita e shpalljes.
- Studentët që kanë thyer Rregulloret në fuqi në Qendrën e Studentëve nuk do të pranohen në konvikte.
- Në konvikte do të pranohen studentët me numrin më të madh të pikëve të fituara.
- Publikimi i rezultateve bëhet me datë **26.09.2022** në tabelat e konvikteve dhe faqet zyrtare të QSP.
- Afati për ushtrimin e ankesave **ONLINE** është **27 – 28.09. 2022.**
- Publikimi i rezultateve të ankesave bëhet me datën **03.10.2022.**

Drejtoria e Qendrës së Studentëve, Prishtinë